



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.524/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Kaçanik, për shkak të mbajtjes së tubimit elektorale pa paralajmërim, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet e pasafatshme ankesa**, e identifikuar me numër A.nr. 524/2021, e datës 16.02.2021, e paraqitur nga Komisionit Komunal të Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Kaçanik, për shkak të mbajtjes së tubimit elektorale pa paralajmërim.

## A r s y e t i m

Me datë 16.02.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, në të cilin parashtuesi i ankesës pretendon se me datën 10.02.2021, nga stacioni policor Kaçanik, ka pranuar një raport të monitorimit të tubimit partiak të PDK-së, që nuk ka qenë i autorizuar nga ana e KKZ-së. Me këtë rast nga ana e këtij subjekti është bërë shkelja e nenit 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.13/2013. Parashtuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme**

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Kaçanik, e datës 16.02.2021, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” i cili përcakton se: *“Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”*. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezultoi se parashtuesi ankesën e ka dorëzuar me postë me datë 13.02.2021 dhe e njëjta është paraqitur

pranë PZAP-it me datën 16.02.2021, ndërsa afati prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja e supozuar në ankesë ka qenë me datën 10.02.2021, që do të thotë se ankuesi, ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat”.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat, nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A.nr. 524/2021 me datë 18.02.2021

**Kryesuese e Panelit**

**Kymete Kica**

*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet e drejta në ankesës.*

